

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e nëntë të rregullt , e mbajtur më datën 28.10.2025, merr këtë:

VENDIM NR.51/2025/KG

**PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT NGA MBLEDHJA E KUVENDIT, E
MBAJTUR MË DATËN 26.09.2025**

Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e tetë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 26.09.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e tetë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 26.09.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević




PROCESVERBALI

Nga mbledhja e tetë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 26.09.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 12 asamblistë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 7 asamblistë: Vlladica Qurçiq, Sonja Odalloviq, Millosh Todoroviq, Dragan Maksimoviq, Bojan Zhiviq, Stefan Mitroviq dhe Biljana Kapetanoviq. Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Shërbimi për Përkthim, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e propozuar të ditës.

Kryesuesi e vuri në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e rregullt, e mbajtur më datën 29.08.2025.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-buxhetit të Komunës së Graçanicës për periudhën 2026-2028, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2026, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
4. Informatat për fillimin e vitit shkollor, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e rregullt, e mbajtur më datën 29.08.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-buxhetit të Komunës së Graçanicës për periudhën 2026-2028, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, tha se buxheti i Komunës së Graçanicës për vitin 2026 është 12.530.000 euro, i cili në krahasim me buxhetin e vitit 2025 është më i lartë për 2.770.00 euro, në bazë të regjistrimit të popullsisë nga viti 2024, ku janë regjistruar 18.485 banorë. “Së bashku me materialin, ju e keni marrë edhe listën e projekteve kapitale që do të zbatohen në vitin 2026 dhe parashikimet për vitet 2027 dhe 2028”.

Asamblisti Dushan Borisavljeviq, para partisë “SRPSKA”, tha se herën e fundit kanë marrë informacion nga drejtori Niçiq se kanë humbur një grant prej rreth 1.500.000 euro. Ai pyeti nëse buxheti për vitin 2026 do të rritet, pasi një numër i caktuar i serbëve janë regjistruar më vonë, sepse rreth 150 serbë mungonin në mënyrë që Komuna e Graçanicës të ketë një popullsi me shumicë serbe.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se për vitin 2026 janë publikuar të dhënat dhe nuk mund të ndryshojnë, ndërsa regjistrimi i popullsisë për komunitetet pakicë është zgjatur dy here.

Kryesuesi shtoi se ai personalisht është regjistruar, por nuk ishte verifikuar më pas nga verifikuesi në Pristinë dhe ekziston problemi se as në sistem nuk mund të verifikohet kjo.

Asamblistja Snezhana Jovanoviç, para partisë “SRPSKA”, pyeti a do të realizohen deri në vitin 2028 projektet kapitale të listuara.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se projektet e listuara në vitin 2026 do të implementohen, ndërsa projektet në vitet 2027 dhe 2028 mund të ndryshojnë.

Asamblisti Millosh Dimiq, para partisë “SRPSKA”, pyeti se ku është planifikuar zbatimi i projektit “Ndërtimi i ndërtesës për banim social”.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se projekti është planifikuar për vitin 2027 dhe 2028 dhe me siguri do të jetë në Graçanicë ose Llapllasellë, por ky projekt mund të ndryshojë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për caktimin e normave tatimore për pronën e paluajtshme për vitin 2026, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, theksoi se norma tatimore varion nga 0.10 deri në 1%, ndërsa normat tatimore të Komunës së Graçanicës variojnë nga 0.10 deri në 0.18% dhe janë identike me normat tatimore të vitit 2025. Me sugjerimin e Shërbimit për Çështjet e Kuvendit, në nenin 3 të propozim-Vendimit duhet të korrigjohet gabimi teknik, në vend të vitit 2025, duhet të jetë viti 2026.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 12 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Informatat për fillimin e vitit shkollor, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Brankica Niçiq.

Kryesuesi propozoi që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, meqenëse askush nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës nuk erdhi për ta shpjeguar atë.


Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Të ndryshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:15.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević